



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ( )  
ADRESA  
NR.7, RR  
GODINA  
TEL:

# KONTRATË KONCESIONI

Nr. repertori: 1201

Nr. koleksioni: 382

Tirane më 27/04/2022

**Ligjet referuese:**

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

\*Akti notarial përbëhet nga 2 flete



A2022053840042226077



A20220338400422260

REPUBLIKA E SHQIPERISË  
ZYRA E NOTERISË TIRANË

NR. 1201 Rep.

NR. 281 Kol.



## AMENDIM KONTRATE

PËR

NJË NDRYSHIM NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”  
(NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM)  
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “DARSI 1”, “DARSI 2”, “DARSI 3”,  
“DARSI 4”, E NDRYSHUAR”

Në Tiranë, më datë 27, muaji Prill, viti 2022 (dymijë e njëzetë e dy), para meje noter \_\_\_\_\_ anëtar i dhomës së Noterisë \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me autorizim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 1893 Prot., datë 24.02.2022 (kopje bashkëlidhur) nga Z. \_\_\_\_\_ shtetas shqiptar, i datëlindjes \_\_\_\_\_, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftim me Nr. \_\_\_\_\_ dhe nr. Personal ID \_\_\_\_\_ (në vijim referuar si “Autoriteti Kontraktor” ose “MIE”).

DHE

Shoqërisë koncesionare “**HENZ ENERGY**” sh.p.k, themeluar si person juridik datë 26.02.2009 dhe regjistruar në QKB datë 02.03.2009, me NUIS K91502021A, e përfaqësuar ligjërisht nga administratori i shoqërisë Z. J \_\_\_\_\_ datëlindjes \_\_\_\_\_ madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftim me Nr. \_\_\_\_\_ dhe nr. Personal \_\_\_\_\_

**të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:**

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë Koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim – Operim – Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve “Darsi 1”, “Darsi 2”, “Darsi 3”, “Darsi 4”, me Nr. 286 Rep., Nr. 39 Kol., lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “KLENIS” sh.p.k, “ILIRIADA” sh.p.k dhe “SHQIPONJA M” sh.p.k (Koncesionari), hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datë 30 Janar 2009, e ndryshuar,



e Kontratën shtesë Nr. 2164 Rep., Nr.268 Kol., datë 03.07.2009 "Marrëveshje për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim, Operim, Transferim) të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Klenis" sh.p.k, "Iliriada" sh.p.k dhe "Shqiponja M" sh.p.k për ndërtimin e hidrocentraleve "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3", "Darsi 4", Kontratën shtesë Nr. 42 Rep., Nr. 13 Kol., datë 23.07.2013, Kontratën shtesë Nr. 4678 Rep., Nr. 1424 Kol., datë 06.08.2013, Kontratën Shtesë Nr. 252 Rep., Nr. 132 Kol., datë 06.05.2014, Kontratën Shtesë Nr. 444 Rep., Nr. 203/1 Kol., datë 06.08.2015, Kontratën Shtesë Nr. 711 Rep., Nr. 302 Kol., datë 25.05.2017 dhe kontratën Shtesë Nr. 2105 Rep., Nr. 1120/2 Kol., datë 28.09.2018

## Hyrje

### Duke pasur parasysh që:

- Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive "KLENIS" sh.p. k, "ILIRIADA" sh.p. k dhe "SHQIPONJA M" sh.p. k (Koncesionari) është lidhur Kontrata e Koncesionit e formës "BOT" me me Nr. 286 Rep., Nr. 39 Kol., për ndërtimin e hidrocentraleve "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3", "Darsi 4", hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datë 30 Janar 2009 (në vijim referuar si **Kontrata e Koncesionit**), e ndryshuar me:
- Kontratën Shtesë Nr. 2164 Rep., Nr.268 Kol., datë 03.07.2009 "Marrëveshje për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim, Operim, Transferim) të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Klenis" sh.p.k, "Iliriada" sh.p.k dhe "Shqiponja M" sh.p.k për ndërtimin e hidrocentraleve "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3", "Darsi 4"
- Kontratën Shtesë Nr. 42 Rep., Nr. 13 Kol., datë 23.07.2013 "Kontratë Shtesë Koncesioni për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim-Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3" dhe "Darsi 4" bazuar në VKM Nr. 448, datë 16.06.2010";
- Kontratën shtesë Nr. 4678 Rep., Nr. 1424 Kol., datë 06.08.2013 "Kontratë Shtesë Koncesioni për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim- Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3";
- Kontratën Shtesë Nr. 252 Rep., Nr. 132 Kol., datë 06.05.2014 "Kontratë Shtesë Koncesioni për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim- Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3";
- Kontratën Shtesë Nr. 444 Rep., Nr. 203/1 Kol., datë 06.08.2015 "Kontratë Shtesë Koncesioni për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim- Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3";



Kontratën Shtesë Nr. 711 Rep., Nr. 302 Kol., datë 25.05.2017 “Kontratë Shtesë Koncesioni për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim – Operim- Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve “Darsi 1”, “Darsi 2”, “Darsi 3”;

- Kontratën Shtesë Nr. 2105 Rep., Nr. 1120/2 Kol., datë 28.09.2018 “Amendim Kontrate për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim – Operim- Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve “Darsi 1”, “Darsi 2”, “Darsi 3”, “Darsi 4”, e ndryshuar;
- Shoqëria koncesionare “HENZ ENERGY” sh.p.k me shkresën Nr. 26 Prot., datë 09.07.2021 “Kërkesë për amendimin e kontratës lidhur me programin e punimeve si dhe shtyrjen e afatit për të përfunduar vënien në punë të hidrocentralit”, protokolluar në MIE me Nr. 5542 Prot., datë 09.07.2021, ka kërkuar amendimin e kontratës lidhur me programin e punimeve si dhe shtyrjen e afatit për të përfunduar vënien në punë të hidrocentralit për shkak se gjatë kryerjes së punimeve për ndërtimin e hidrocentralit është gjendur në kushtet e forcës madhore si pasojë e pandemisë së COVID – 19.
- MIE me shkresën Nr. 5542/1 Prot., datë 05.11.2021 “Mbi kërkesën tuaj për amendimin e afateve të kontratës koncesionare” drejtuar shoqërisë koncesionare në kuadër të vlerësimit të kërkesës, ka kërkuar informacion lidhur me punimet e realizuara nga shoqëria koncesionare;
- Shoqëria koncesionare me shkresën Nr. 40 Prot., datë 11.11.2021 “Kthim përgjigje shkresës suaj Nr. 5542/2 Prot., datë 11.11.2021 “Kthim përgjigje shkresës suaj Nr. 5542/1 Prot., datë 05.11.2021 “Mbi kërkesën tuaj për amendimin e afateve të kontratës koncesionare” ka informuar mbi punimet e realizuara në përputhje me objektin e kontratës.
- Palët njohin dhe pranojnë kufizimet dhe vonesat e shkaktuara për shkak të pandemisë së krijuar nga COVID-19.

Mbështetur në nenin 28 “Ndryshime” të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se:

- 28.1 Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe /ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve;
- 28.2 Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Në nenin 29 “Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit“ të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit;

Në Kontratën e Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim – Operim – Transferim) me Nr. 286 Rep., Nr. 39 Kol., lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “KLENIS” sh.p.k,



LIRIADA” sh.p.k dhe “SHQIPONJA M” sh.p.k (Koncesionari), për ndërtimin e hidrocentraleve “Darsi 1”, “Darsi 2”, “Darsi 3”, “Darsi 4”, hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datë 30 Janar 2009, të ndryshuar të bëhen ndryshimet e mëposhtme:



### Neni 1

Në nenin 10 “Programi i Punimeve” pika 2 zëvendësohet me shprehjen “Koncesionari merr përsipër të vendosi në punë hidrocentralin brenda një afati prej 12 muajsh nga pajisja me lejen shtesë (ose zgjatjen e afatit të lejes ekzistuese) të ndërtimit nga institucionet përkatëse.

Afati për pajisjen me lejen shtesë të ndërtimit është jo më shumë se 12 muaj nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate shtesë.

### Neni 2

Kjo Kontratë Shtesë koncesioni hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët.

Kontrata Shtesë e Koncesionit u hartua në 5 (pesë) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

### PALËT

**AUTORITETI KONTRAKTUES**

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË**

**Përfaqësuar me Autorizim Nr. 1893 datë  
24.02.2022 të Ministrit të Infrastrukturës  
dhe Energjisë**

**SHOQËRIA KONCESIONARE**

**“HENZ ENERGY” SH.P.K**

**Administrator**

**Z.**

^